
	<p align="center">Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo</p> <p align="center">Komuna e Vitisë Opstina Vitina-Municipality of Vitina</p>	
<p align="center">19-04-2019</p>		
<p align="center">ZYRA E PROKURIMIT</p> <p align="center">02-370/03-417</p>		

KONTRATË SHITJE

SHITJA E MASËS DRUSORE,NJËSIA MENAXHUESE – KOPILAQË NR.80,81

PJESAI E KONTRATËS: KONTRATA
SHITJA E MASËS DRUSORE,NJËSIA MENAXHUESE –KOPILAQË NR. 80,81,
 me nr identifikues: **VI657-2019-001**
Neni 1 Lënda

KJO KONTRATË e lidhur më **18.04.2019** në mes të: *Komuna e Vitisë*, këtu e tutje i referuar me "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë, dhe *Ntsh. 'DARDANI'* (këtu e tutje i referuar si "Blerësi"), në anën tjetër:

NDËRSA Autoriteti Kontraktues ka ftuar tenderët për shitje të aseteve, **SHITJA E MASËS DRUSORE,NJËSIA MENAXHUESE –KOPILAQË NR.80,81**, dhe ka pranuar Tenderin e dorëzuar nga Blerësi për blerjen e këtyre aseteve.

TANI KJO MARRËVESHJE DËSHMON SI NË VIJIM:

1. Blerësi pajtohet të paguaj Autoritetin Kontraktues për marrjen e Asetit, Çmimin e Kontratës në kohën dhe mënyrën e përcaktuar me Kontratë.
2. Duke konsideruar pagesat e kryera nga Blerësi, Autoriteti Kontraktues, siç theksohet në Kontratë, pajtohet të lëshoj Asetet në pajtim me dispozitat e kontratës.

Neni 2 Lokacioni i Aseteve

2.1 Lokacioni i aseteve është **Kopilaqa 80/81, komuna e Vitisë**

2.2 Zyrtari që duhet kontaktuar për aranzhimin e marrjes së aseteve është **Kadri Ismajli**

Neni 3 Çmimi i kontratës

3.1 Çmimi total do të jetë: **23,659.12 €**,

Me fjalë: **Njëzet e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjete e nentë Euro/ 12 centi**

Sasia e tërheqjes është sipas paramasës së kontraktuar; Ngastra Kopilaqa nr.80/81 .

Sasia e përgjithshme është 181.0 m³ dru teknik dhe 1,335.0 m³ dru zjarri,

Në xhirollogarinë me nr. 1000 6503 0000 0020 –

- 3.2 PAGESA TË BËHET **30%**,ME RASTIN NËNSHKRIMIT TE KONTRATËS, TJETRA SHUME BEHET NE PROCES
- 3.4 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Blerësi i ka borxh
- 3.5 Çmimi do të jetë përfundimtar dhe nuk do të ndryshohet.
- 3.6 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme të kontratës.
- 3.7 Kjo kontrate nënshkruhet me vonesë , për shkak të kushteve atmosferike për tërheqjen e masës drusore.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (c) Përshkrimi i Aseteve;
- (d) Tenderi i Blerësit.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Blerësit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhet me shkrim. Komunikimet do të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën **[shqipe]¹** në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Blerësin.

Për Kontraktuesin:

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Hajdin Leskovica	Emri:	Fadil ABAZI
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Menaxher i Prokurimit
Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>	Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>
Data:	<i>18.04.2019</i>	Data:	<i>18/04/2019</i>
Vula:		Vula:	

¹ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

PJESA II E KONTRATES KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

- 1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Blerësit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.
- 1.2 "Asetet" në lidhje me këtë kontratë përkufizohen në Përshkrimin e Aseteve.
- 1.3 "Autoriteti Kontraktues" nënkupton autoritetin që shet Shërbimet, siç specifikohet në Fletën e të Dhënave të Tenderit
- 1.4 " Blerësi" do të thotë një person natyral ose ligjorë që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate bënë blerjen e asetëve të cilat janë objekt i kësaj kontrate.
- 1.5 "Palë" nënkupton palët që nënshkruajnë kontratën.
- 1.6 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma që do ti paguhet autoriteti kontraktues sipas specifikimit në formën e kontratës.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

- 2.1 Ligjet e Kosovës në fuqi do të aplikohen në të gjitha çështjet që nuk mbulohen me dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata relevante në Prishtinë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet me shkrim në mes të palëve do të hartohen në gjuhën e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Neni 3 Gjendja e Aseteve

- 3.1 Autoriteti Kontraktues do të shet asetet në baza "të gjendjes aktuale, dhe lokacionit aktual" dhe nuk do të ofroj asnjë garanci apo Garancion në lidhje me gjendjen e asetëve.
- 3.2 Blerësi do të mbaj përgjegjësinë e plotë për asetet nga data dhe koha e transferim dhe do të ketë përsipër të gjitha kostot dhe rreziqet në lidhje me asetet në vazhdimësi.

Neni 4 Parimet e përgjithshme të pagesës

- 4.1 Pagesat do të bëhen në Euro.
- 4.2 Blerësi do të bëjë pagesën për Autoritetin Kontraktues në shumën e plotë të Kontratës, siç është përkufizuar në formën e kontratës, brenda dy javë nga data e kontratës. Autoriteti kontraktues do të lëshojë një fletëpranim si dëshmi të pagesës.
- 4.3 Pagesa do të bëhet në llogarinë bankare të Autoritetit Kontraktues të cekur në Nenin III dhe do të konsiderohet si pagesë në datën kur kreditohet në llogarinë e Autoritetit Kontraktues.
- 4.4 Autoriteti Kontraktues mund të ndërpresë këtë kontratë nëse Blerësi ka dështuar të paguaj Çmimin e Plotë të Kontratës brenda një jave nga afati i fundit për pagesë.

5. Transferi i Aseteve

- 5.1 Lokacioni i asetëve është i specifikuar në Formën e Kontratës.
- 5.2 Blerësi do të ketë përgjegjësi të plotë dhe do të bartë të gjitha rreziqet dhe kostot lidhur me marrjen, çmontimin,

largimin dhe transportimin e aseteve nga lokacioni i përcaktuar më lartë dhe do të bartë dhe paguaj të gjitha kostot e asociuara.

5.3 Blerësi do të marrë asetet brenda një jave nga data kur Autoriteti Kontraktues pranon pagesën për asete .

5.4 Blerësi do të kontaktoj zyrtarin e emëruar në Formën e Kontratës, në adresën e autoritetit kontraktues, siç specifikohet në formën e kontratës, për të aranzhuar datën dhe kohën për marrjen e aseteve.

5.5 Blerësi do të nënshkruaj një Certifikatë të Dorëzimit, që certifikon pranimin e aseteve, në kohën e transferit.

Neni 6 Plani i Veprimit nga Operatori Ekonomik

6.1 Operatori ekonomik në këtë rast ntp „DARDANI” „ është obliguar që pa përjashtim të veproj në bazë të rregullave që do të takojnë shërbimit teknik, të cilat janë në përputhshmëri me Ligjin për Pyjet e Kosovës 2003/03.Udhëzimi Administrativ 06/2010. Rregulloren për rendin Pyjor, Planin vjetor dhe operativ, përfshirë këtu edhe përbushjen e të gjitha aktiviteteve, investimeve, në mirëadministrimin, mirëmbajtjen dhe ndertimin e infrastukturës rrugore konform rregullave dhe standarteve pyjore të përkrahur detalisht në pjesët e kësaj kontrate.

6.2 Punët e tërheqjes së masës drunore duhet të jeta sipas Planit dinamik duke filluar nga data 19.04.2019 deri më 17.10.2019, të aprovuar ose në harmoni me Agjencionin pyjor të Kosovës.

Nga **AK**, organ mbikqyrës në realizimin e këtij projekti është Agjensioni Kosovar i Pyjeve në Viti, (personi zyrtar) ku duhet të raportoj me shkrim për realizimin e projektit. Nderkaq dinamika e punëve të parapara me këtë kontratë duhet të përfundojë me 180 ditë pune ashtu siç është paraparë në këtë Kontratë.

6.3 Pagesa nga ana e blerësit duhet të bëhet në keste, sipas raporteve të kryjes së punëve të caktuara sipas dinamikës së paraparë me plan operativ.

Neni 7 Dinamika e pagesës

Dinamika e pagesës do të jetë;

7.1. 50 % avans menjherë pas nënshkrimit të kontratës, kurse pjesa e mbetur e borxhit do të paguhet në këste tjera të barabarta dhe në rast të mosfillimit të punës, blersit e humbë të drejtën e kompenzimit të avansit.

Neni 8 Obligimet nga Punëdhësi

8.1 Punëdhësi shitësi, **AK** ka për obligim që të prezentoj Planin Operativ të ngastrave nga nenet e lartëcekura të kësaj kontrate. Ndersa njësi Komonale e Komunës së Vitisë, duhet të siguroj stafin profesional për monitorimin dhe dokumentacionin përçjellës për transportim të masës drunore. Përgjegjës për monitorimin e këtij projekti është Agjensioni Kosovar i Pyjeve.

Neni 9 Obligimet e Operatorit Ekonomik (blerësit)

9.1 Nëse punëmarrësi-blerësi nuk i përbush obligimet sipas kësaj kontrate e sidomos ato nga neni 7 dhe në afat prej 5 ditësh nga skadimi i saj, obligohet që 1% të paguaj kamatë për çdo ditë vonesë nga vlera e tërësishme e kontraktuar, pos në rastet specifike të cilat i vleron njësi komonale e Komunës së Vitisë, kur vonesat janë të përvitshme në situatën e krijuar.

9.2 Punëmarrësi-blerësi në rast se nuk e fillon punën brenda afatit të caktuar në nenin 6 të kësaj kontrate ai do të humbë të drejtën e kompenzimit për avansim prej 20%. Dhe në vlerën maksimale të kamatës nuk mund të jetë më e madhe se 30% e vlerës së tërësishme sipas kësaj kontrate.

9.3 Nëse punëmarrësi-blerësi nuk përbush obligimet e tij sipas kësaj kontrate dhe sidomos nuk i përmbahet afateve për pagesë sipas nenit 7 të kësaj kontrate, punëdhësi-shitësi mban të drejtën për shkeputjen e njëanshme të

kesaj kontrate.

9.4 Nëse punëmarrësi gjendet duke vepruar në pyll në kundërshtim me ligjin, duke prerë dhe transportuar masë drunore jashtë sasisë së paraparë me këtë kontratë, apo duke transportuar pa lejen e organit kompetent, nderpritet kjo kontratë, dhe inicohet procedurë gjyqësore dhe nuk do të merren fare në konsiderim aplikimet e tij në tenderet dhe ankandet e ardhshëm.

9.5 Punëmarrësi pas pranimit të ngastres merr për obligim mbrojtjen e sasisë drusore të prerë dhe jo të prerë nga demtuesit ilegal për çdo dëm të shkaktuar (vjedhje) punëmarrësi është i obliguar të ngrit padi ndaj kryesit të veprës dhe me kohë të informon me shkrim organin kompetent.

Neni 10 Mbikqyrja e Kontratës

10.1 Realizimi i kesaj Kontrate i nënshtrohet kontrollit nga ana e përgjegjësve të Kuvendit të Komunës së Vitisë, perkatsisht Agjensioni Kosovar i Pyjeve i cili mund të dergoj komisionet e saja profesionale për kontrollimin e punëve, rrjedhen dhe kryrjen e tyre në rast të parregullsive të konstatuara, dhe mosrespektimit të kesaj kontrate, informon menjëher organin ma të lart Komunal (apo personin mbikqyrës) dhe varsisht nga leshimet ofron afatin për evitimin e tyre dhe me anë të natyrës së tillë që nuk mund të evitohen, propozon shkeputjen e kesaj kontrate.

Neni 11 Forca madhore

11.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

11.2 Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e amikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

11.3 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdërisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

11.4 Nëse Blerësi kërkon shpenzime shtesë për respektimin e udhëzimeve të Autoritetit Kontraktues ose përdorimin e mënyrave alternative nën Nenin 6.3, shumata e tillë duhet të certifikohet nga Autoritetit Kontraktues.

Neni 12 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

12.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

7.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit **Gjykata themelore në Gjilan-dega në Viti**, Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

8.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose një vendim nga **Gjykata themelore në Gjilan-dega në Viti**, në pajtim me Ligjin e Kosovës; ose
- b) kur palët pajtohen, një vendim arbitrimin. Arbitrimi i [specifiko organin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrimit (rregullat e Odës Ndërkombëtare të Biznesit, Komisionit të Kombeve të Bashkuara për Ligjin Ndërkombëtarë të Tregtisë, ose procedurë tjetër të arbitrimit të njohur ndërkombëtarisht)].

8.2 Modeli i zgjidhjes së mosmarrëveshjes p.sh. gjykata apo arbitrim do të vendoset nga palët para nënshkrimit të kontratës

Neni 14

Kjo kontratë është e perpiluar ne kopje te mjaftueshme per te dyja palet kontraktuese

PALËT KONTRAKTUESE

Punëmarrësi-blerësi
Ntsh "DARDANI"


/ Hajdin Eskovica /


Punëdhënësi- shitësi
Komuna e Vitisë


/ Fadil ABAZI /


PJESA C: FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Neni I. Formulari i Tenderit

Për: **Komuna e Vitisë**

(në vazhdim të tekstit "Autoriteti Kontraktues")

Titulli i kontratës: **SHITJA E MASËS DRUSORE, NJËSIA MENAXHUESE –KOPILAQË NR.80,81**

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. I kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjen e dosjes së tenderit me Numër të Prokurimit: **657-2018-001** Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të blejmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:
3. Çmimi total i tenderit është:

Çmimi i tenderit në shifra: 23659.12 €

Dhe në fjalë Nizet e Tërmi e gjordgjim e pesdhet e more Pik Dardollet Euro

4. Ky tender është valid për një periudhë prej 30, nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Ne konfirmojmë që çmimet e kuotuar në Listën e Aseteve dhe Listën e Çmimeve janë finale për periudhën e vlefshmërisë dhe nuk do të mund të ndryshohen ose rishqyrtohen.

6. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj nesh nëse bën këtë

E DORËZUAR NGA

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	<u>N. T. SH. DARDANI</u>
ADRESA E PLOTE	<u>KORBLIQ KAÇANIK.</u>
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI	<u>Hajdin LESKOVICA</u>
POZITA	<u>MENAXHIJER</u>
NËNSHKRIMI	<u>[Signature]</u>
DATA	<u>15.03.2019</u>
VULA	

DOSJA E TENDERIT PËR SHITJE



Neni II. Lista e Aseteve dhe Përshkrimi i Çmimeve

PLOTËSO ÇMIMIN PËR SECILIN ARTIKULL MË POSHTË PËR TË CILIN OFERTONI.

SHITJA E MASËS DRUSORE TE PAPERERA NE MAL, NJËSIA MENAXHUESE –KOPILAQË NGA STRA NR.80,81

REKAPITULLIMI

nr	Njësia menaxhuese	Njesia metëse	Ah	Çmimi fillestar	Çmimi ofertues	Shuma
1	Ngastra Kopilaqe 80	Sasia m3 (dru teknik)	6.70	42.40 €	42,40	284,08
2	Ngastra Kopilaqe 80	Sasia m3 (dru zjarri)	231.20	42.40 €	12,35	2855,32
3	Ngastra Kopilaqe 81	Sasia m3 (dru teknik)	174.30	42.02 €	42,05	7329,31
4	Ngastra Kopilaqe 81	Sasia m3 (dru zjarri)	1,103.80	11.91 €	11,95	13140,41
TOTALI						23659,12



IDENTIFIKIMI OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	N.T.Sh. DARDANI
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË O	Hajbin LESKOVICA
NËNSHKRIMI:	1/kuull.
DATA:	15.03.2014
VULA: (PER PERSONAT FIZIK NR LETERNJOFTIMIT)	

DOSJA E TENDERIT PËR SHITJE

1.
 2.
 3.